



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
REKTORAT

Nr. 1957 prot.

Gjirokastrë, më 18.12. 2024

**Lënda:** Hapet thirrja për shkëmbim stafi në kuadër të Programit Erasmus+ me institucionin arsimor Mestre Mateo Art & Design School

Në kuadër të Programit Erasmus+, Mestre Mateo Art & Design School, anëtar i partneritetit CARTES, hap thirrjen për shkëmbim stafi për trajnim me Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastrë në kuadër të organizimit të Javës Ndërkombëtare të Arteve dhe Dizenjimit.

Sipas Marrëveshjes Ndërinstitucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me **2 pozicione** për staf akademik nga Njësia Bazë e Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies. Aktiviteti do të zhvillohet në periudhën 17-20 shkurt 2025. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht.

Të interesuarit duhet të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **24.12.2024**:

- fotokopje të kontratës së punës;
- letër interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në anglisht;
- provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze, të paktën në nivelin B1;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ-së. Staf i përzgjedhur do të plotësojë një draft "Marrëveshje për Trajnim" dhe më pas, vlerësimi së bashku me marrëveshjen do t'i përcillet institucionit pritës, për përzgjedhjen përfundimtare të aplikantëve.

Zv/Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj

Konceptoi: Irma Gjollëshi

